



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 255 prot.

Tiranë, më 23.01.2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 2292/27, DATË 12.01.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR PËRFUNDIMIN E HETIMIT DISIPLINOR MBI BAZË ANKESE NDAJ MAGJISTRATES K. A., ME DETYRË GJYQTARE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, TIRANË"**

**Për Znj. Edjona Hoxha,**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e znj. Edjona Hoxha, në të cilën ngrihen pretendime ndaj magjistrates K. A, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar. Me vendimin nr. 2292/27, datë 12.01.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për përfundimin e hetimit disiplinor mbi bazë ankese ndaj magjistrates K. A., me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë", ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor, bazuar në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Rruga "Tish Daija", Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

